

VENDIM
Nr. 31, datë 6.6.2007

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR LICENCIMIN, ORGANIZIMIN,
VEPRIMTARINË DHE MBIKËQYRJEN E ZYRAVE TË KËMBIMIT VALUTOR”**

*(Ndryshuar me vendimin nr. 73, datë 27.11.2007; nr. 82, datë 14.12.2011; nr. 31, datë
30.4.2014; nr. 48, datë 30.3.2016; nr. 49, datë 3.7.2019; nr. 42, datë 3.9.2025)*

(i përditësuar)

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve dhe i rregullave për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor.

Neni 2

Baza ligjore

(Shtuar shkronja “c” me vendimin nr. 49, datë 3.7.2019)

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- a) nenit 1, pika 4 shkronja “b”, nenit 12, shkronja “b”, nenit 43, shkronja “c” dhe nenit 61, shkronja “b” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- b) nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”;
- c) ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar.

Neni 3

Përkufizime

(Zëvendësuar togfjalësh në shkronjën “e”, pika 4 me vendimin nr. 73, datë 27.11.2007; shtuar togfjalësh në pikën 3 të shkronjës “e”, shtuar pika 7, shtuar togfjalësh në pikën 4 të shkronjës “f”, ndryshuar shkronja “j” me vendimin nr. 31, datë 30.4.2014; shfuqizuar shkronja “j” me vendimin nr. 48, datë 30.3.2016; shtuar togfjalësh dhe shkronjat “m” dhe “n” me vendimin nr. 49, datë 3.7.2019; ndryshuar shkronja “b”, pikat 2 dhe 7 të shkronjës “e”, shtuar shkronjat “o”, “p” dhe “q” me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

Për efekt të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e përdorur kanë të njëjtin kuptim si në nenin 4 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) “Valutë” - janë mjetet financiare në formën e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike të huaja, të cilat kanë kurs ligjor.
- b) “Veprimtari e këmbimit valutor” - është veprimtaria e shitblerjes së valutave në para fizike, ose nëpërmjet llogarive bankare ose llogarive të pagesave.
- c) “Subjekt” - është personi juridik, i cili aplikon dhe licencohet, si zyrë e këmbimit valutor, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
- d) “Zyra” - është ambienti në të cilin ushtrohet veprimtaria e këmbimit valutor.

- e) “Të dhëna identifikuese” për një subjekt janë:
1. emri i tij tregtar;
 2. numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS).
 3. adresa e selisë dhe adresa e zyrave ku ushtron veprimtarinë/të, përfshirë dhe adresën/at elektronike;
 4. objekti i veprimtarisë së tij tregtare të përcaktuar në vendimin e regjistrimit të subjektit;
 5. emrat e kambistëve; si dhe
 6. emri, mbiemri dhe nënshkrimi i administratorit të kësaj zyre;
 7. emrat e aksionerëve ose ortakëve dhe të pronarëve përfitues.
- f) “Faturë” - është dokumenti i lëshuar nga zyra e këmbimit valutor për çdo transaksion këmbimi, i cili përmban:
1. llojin e monedhës;
 2. shumën dhe kursin e këmbimit;
 3. vlerën e këmbyer;
 4. komisionin (nëse aplikohet);
 5. emrin, adresën dhe kodin fiskal të zyrës; si dhe
 6. numrin rendor të dokumentit.
- g) “Bilanci në valutë” - është dokumenti në të cilin hidhen të dhënat ditore për të gjitha transaksionet e kryera, sipas informacionit të dhënë në faturë.
- h) “Kurs këmbimi” - është çmimi relativ i një monedhe të shprehur në njësi të një monedhe tjetër, në një datë të caktuar.
- i) “Agjent”- është personi juridik, i cili merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën e agjencisë, sipas përcaktimeve të bëra në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.
- j) Shfuqizuar.
- k) “Banka” – është Banka e Shqipërisë.
- m) aksione të mbajtësit (bearer shares), janë aksione të një personi juridik, pronësia e të cilave i kalon personit që zotëron/mban certifikatën/dokumentin e aksioneve të mbajtësit, pa pasur nevojë për marrëveshje/kontratë për kalimin e pronësisë së këtyre aksioneve;
- n) aksioner përfaqësues (nominee shareholder), është aksioneri i regjistruar i një personi juridik, që mban aksionet në emër të aksionerit aktual (pronarit përfitues), në bazë të një marrëveshjeje;
- o) “Pronar përfitues” - do të ketë të njëjtin kuptim të përcaktuar në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 112, datë 29.7.2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar, pavarësisht nivelit të pronësisë së mbajtur në aksione/kuota të kapitalit ose interesa të pronësisë në një subjekt.
- p) “Llogari pagese” – ka të njëjtin kuptim si në nenin 5, pika 21 të ligjit nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”.
- q) “Njësi e kontrollit të brendshëm” - është njësi organizative e veçantë e subjektit, e pavarur nga veprimtaritë, strukturat dhe personat që ajo shqyrton ose kontrollon, e cila raporton përpara ortakut/aksionerit ose organeve drejtuese të subjektit.

Neni 4

Licencimi i veprimtarisë së këmbimit valutor

Subjekti licencohet nga Banka, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, për të ushtruar veprimtarinë e këmbimit valutor.

Neni 5

Miratimi i veprimtarisë shtesë për subjektin

(Shtuar togfjalësh kudo në nen me vendimin nr. 31, datë 30.4.2014; shfuqizuar me vendimin nr. 48, datë 30.3.2016)

KREU II

LICENCIMI I SUBJEKTIT

Ndryshuar me vendimin e BSH nr. 48, datë 30.3.2016)

Neni 6

Dokumentacioni për licencim

(Zëvendësuar togfjalësh në shkronjën “g”, pika 1 me vendimin nr. 73, datë 27.11.2007; ndryshuar shkronja “a”, shtuar fjalë në nënpikën “iii” në shkronjën “b”, shtuar shkronjat “h”, “i” dhe “j” në pikën 1 me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011; ndryshuar fjalë e fundit e shkronjës “j” me vendimin nr. 31, datë 30.4.2014; shtuar shkronja “b/1”, zëvendësuar togfjalësh në shkronjën “f” në pikën 1 me vendimin nr. 49, datë 3.7.2019; ndryshuar togfjalësh në shkronjën “a”, “b/1” të pikës 1 dhe në pikën 2, ndryshuar shkronja “c”; shfuqizuar togfjalësh në nëndarjen “iii” të shkronjës “b” dhe shkronja “d” në pikën 1; shtuar shkronja “b/2” dhe “k” në pikën 1 me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

1. Kërkesa për licencim bëhet me shkrim nga administratori i subjektit ose personi i autorizuar ligjërisht prej tij dhe shoqërohet me të dhënat identifikuese, të përcaktuara në aneksin 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje, si dhe me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Ekstraktin e regjistrit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, për regjistrimin e subjektit si person juridik, në të cilin të jetë e shprehur si objekt i veprimtarisë së shoqërisë, veprimtaria financiare e këmbimeve valutore.

b) Vërtetime të lëshuara nga organet kompetente, sipas juridiksionit territorial për aksionerët ose ortakët, pronarët përfitues, administratorin dhe kambistët, të cilat vërtetojnë faktet e mëposhtme juridike:

i) vërtetim se personi nuk është në ndjekje penale;

ii) vërtetim se personi nuk është në gjykim për vepra penale;

iii) vërtetim nga Ministria e Drejtësisë se personi nuk është i dënuar penalisht;

iv) vërtetim nga Zyra e Përmbartimit Gjyqësor se personi nuk ka detyrime pasurore të pashlyera.

Dokumentet e lartpërmendura duhet të jenë lëshuar jo më larg se 3 (tre) muaj nga dita e paraqitjes së aplikimit për licencë.

b/1) Deklaratën personale të aksionerëve/ortakëve, pronarëve përfitues dhe të administratorit për lidhje të mundshme familjare apo marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (sipas aneksit nr. 9, të kësaj rregulloreje).

b/2) Dokumentacionin për kapitalin fillestar dhe burimin e tij:

i. deklarata noteriale të aksionerëve/ortakëve, se burimi i kapitalit fillestar të paguar të subjektit nuk është hua, kredi ose paradhënie nga subjekte të treta,

ii. deklarata noteriale të aksionerëve/ortakëve mbi burimin e krijimit të kapitalit fillestar të paguar dhe për çdo shtesë të tij gjatë zhvillimit të veprimtarisë, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- për personat juridikë:

evidenca e burimit të krijimit të fondeve, e paraqitur në një formë të pranueshme ligjore (raporti i ekspertit kontabël të autorizuar, bilanci kontabël vjetor, dhurata ose burime të tjera të destinuara për blerjen e aksioneve/kuotave të subjektit dhe certifikata e autoriteteve

kompetente që siguron të dhëna për bilancin e shoqërisë dhe rregullshmërinë e pagesës së tatimeve dhe taksave (për personat juridikë të huaj – aktet e barasvlershme/ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit/juridiksionit të huaj);

- për individët ose personat fizikë tregtarë:

evidenca e burimit të krijimit të fondeve, e paraqitur në një formë të pranueshme ligjore (blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka ose të tjera evidenca të burimit të fondeve) dhe certifikata e autoriteteve përkatëse fiskale shtetërore lidhur me shlyerjen e detyrimeve tatimore.

c) Kopje të noterizuar të dokumentit identifikues të administratorit, kambistëve, aksionerëve ose ortakëve dhe pronarëve përfitues.

d) Shfuqizuar.

e) 2 (dy) fotografi për çdo kambist të subjektit, të cilat përdoren nga Banka për përgatitjen e kartave të identifikimit të tyre.

f) Dokumentin vërtetues mbi nivelin e arsimimit të administratorit (diplomë universitare).

g) Certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor.

h) Vërtetim nga banka ose dega e bankës së huaj të licencuar nga Banka, që subjekti ka bllokuar shumën e kapitalit të kërkuar sipas nenit 8, pika 1 në një llogari pranë saj. Kjo shumë, zhbllokohet nëpërmjet njoftimit të Bankës, në përfundim të procedurës së licencimit;

h) Deklaratën e nënshkruar nga administratori i personit juridik, sipas aneksit nr.5 të kësaj rregulloreje, mbi njohjen dhe zbatueshmërinë e detyrimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi për ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor;

i) informacion mbi pajisjet e nevojshme teknike/administrative që zyra disponon për ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor, siç listohen në aneksin nr.6, bashkëngjitur dhe pjesë e kësaj rregulloreje;

j) informacion mbi mjediset dhe kushtet e sigurisë për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor, në zbatim të akteve nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë për këtë qëllim. Dokumentacioni i kërkuar sipas kësaj shkronje, duhet të përmbajë të paktën informacion për mjediset dhe kushtet e sigurisë të përcaktuara në aneksin nr. 7 bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

k) Formularin e parashikuar në aneksin nr. 10 të kësaj rregulloreje, për regjistrimin në Sistemin Elektronik Raportues Rregullator (ERRS), për qëllime të raportimit të veprimeve të këmbimeve valutore sipas nenit 19, pika 1 të kësaj rregulloreje.

2. Dokumentacioni sipas pikës 1 të këtij neni duhet të jetë në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar/legalizuar. Ai dorëzohet në Bankë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.

Neni 7

Kërkesat në lidhje me dokumentacionin për miratimin e veprimtarisë shtesë

(Ndryshuar shkronja "a" e pikës 1 me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011; shtuar togfjalësh në shkronjën "a" me vendimin nr. 31, datë 30.4.2014; shfuqizuar me vendimin nr. 48, datë 30.3.2016)

Neni 8

Kërkesa për kapitalin

(Ndryshuar pika 2, zëvendësuar fjalë në pikën 3 me vendimin nr. 73, datë 27.11.2007; shtuar togfjalësh në pikën 2 me vendimin nr. 31, datë 30.4.2014; shfuqizuar pika 2, ndryshuar pika 3 me vendimin nr. 48, datë 30.3.2016; zëvendësuar togfjalësh në pikën 1 me vendimin nr. 49, datë 3.7.2019; ndryshuar togfjalësh në pikën 1, shtuar pikat 4 e 5 dhe fjali në pikën 3 me

vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

1. Kapitali fillestar minimal i kërkuar për t'u licencuar nga Banka për të kryer veprimtarinë e këmbimit valutor, është 5,000,000 lekë ose kundërvlera e tij në dollarë amerikanë (USD), ose në monedhën europiane, euro.

2. Shfuqizuar.

3. Kapitali i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, derdhet në një llogari bankare, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e derdhjes. Në çdo rast, nëse gjatë procesit të licencimit nuk plotësohet kundërvlera në lekë si pasojë e luhatjeve të kursit të këmbimit, Banka e Shqipërisë mund të kërkojë plotësimin e shumës së depozituar të kapitalit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

4. Çdo pagesë e kapitalit fillestar minimal, çdo shtesë e mëvonshme e tij, si dhe çdo ndryshim në strukturën e kapitalit, shoqërohet me paraqitjen në Bankën e Shqipërisë të informacionit lidhur me burimin e krijimit të këtij kapitali, sipas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 6, pika 1, shkronja "b/2" të kësaj rregulloreje.

5. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë sqarime dhe të bëjë verifikime të mëtejshme lidhur me burimin e krijimit të kontributeve/fondeve që do të shërbejnë si kapital fillestar minimal ose si shtesë e mëvonshme e tij.

Neni 9

Shqyrtimi i kërkesës për licencim

(Hequr shkronjë në pikën 2 me vendimin nr. 73, datë 27.11.2007; hequr fjalë në fjalinë e parë dhe shfuqizuar fjalë e dytë në pikën 4 me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011; hequr togfjalësh në pikën 4 me vendimin nr. 48, datë 30.3.2016; shtuar pika 5 dhe 6 me vendimin nr. 49, datë 3.7.2019; ndryshuar togfjalësh në pikat 5 dhe 6, shtuar fjali në pikën 3, shtuar pikat 5/1, 7 dhe 8 me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

1. Banka, në rast se konstaton që kërkesa për licencim dhe dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti nuk janë të plota në përputhje me kërkesat e nenit 6 të kësaj rregulloreje, njofton subjektin brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga marrja e këtij dokumentacioni, për nevojën e plotësimit të mëtejshëm të tij.

2. Subjekti duhet të paraqesë të dhënat dhe/ose dokumentacionin kërkuar nga Banka dhe brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve pune nga dërgimi i njoftimit, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Banka ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për licencë, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për licencim nuk plotësohet nga subjekti brenda 3 (tre) muajve pas datës së aplikimit fillestar për licencë, sipas pikës 1 të këtij neni dhe njofton subjektin për sa më sipër. Subjekti ka të drejtë të riaplikojë për licencim, duke paraqitur dokumentacionin e ri. E drejta për të riparaqitur kërkesë për licencim, nuk mund të ushtrohet më shumë se një herë, me përjashtim të rasteve kur mosrespektimi i afatit kohor të parashikuar në këtë pikë, ka ardhur për shkaqe madhore.

4. Pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë, sipas kërkesave të parashikuara në nenin 6, rastit, Banka inspekton zyrën/zyrat ku është parashikuar të zhvillohet veprimtaria e këmbimit valutor, me qëllim verifikimin e plotësimit të sigurisë për kryerjen e kësaj veprimtarie, në zbatim të akteve nënligjore të nxjerra nga Banka për këtë qëllim.

5. Banka e Shqipërisë, për të kryer vlerësimet e parashikuara në këtë nen, përveç shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, bashkëpunon dhe kërkon informacion nga autoritetet mbikëqyrëse homologe dhe institucionet e specializuara për luftën kundër krimit ekonomik dhe krimit të organizuar dhe për parandalimin e pastrimit të parave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Tatim Taksave, etj.

5/1. Banka e Shqipërisë, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit të aksionarëve/ortakëve, pronarëve përfitues, administratorit dhe kambistëve, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe të Bashkimit Evropian (BE), njoftimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), si dhe listat e integruara të personave të shpallur.

6. Në rast se Banka e Shqipërisë konstaton, apo ka dyshime të arsyeshme se struktura e kapitalit apo burimi i tij lidhet me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë, që kanë lidhje familjare apo marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me aksionerët/ortakët dhe pronarët përfitues, apo lidhet me shoqëri të regjistruara në parajsa fiskale ose offshore, njofton dhe kërkon nga Agjencia e Inteligjencës Financiare, nëse ka informacion në lidhje me aksionerët/ortakët dhe pronarët përfitues, si dhe pezullon procedurën e licencimit deri në një përgjigje nga kjo e fundit.

7. Banka e Shqipërisë vlerëson përshtatshmërinë, reputacionin e mirë dhe integritetin e aksionerit/ortakut, pronarit përfitues dhe administratorit të subjektit gjatë momentit të licencimit, si dhe sa herë që ka ndryshime në përbërjen e strukturës së pronësisë dhe organeve drejtuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

8. Për qëllime të kësaj rregulloreje, person me “reputacion të mirë” konsiderohet aksioneri/ortaku, pronari përfitues dhe administratori i subjektit, i cili karakterizohet nga etika profesionale dhe integriteti moral dhe financiar, si dhe përputhshmëria me kuadrin ligjor e rregullativ. Një aksioner/ortak, pronar përfitues apo administrator do të konsiderohet të ketë reputacion të mirë, nëse plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) nuk është në ndjekje penale;
- b) nuk është në gjykim për vepra penale;
- c) nuk është i dënuar penalisht;
- d) nuk ka detyrime pasurore të pashlyera;
- e) nuk bën pjesë në listat e shpallura të sanksioneve ndërkombëtare.

Neni 10

Licenca

(Zëvendësuar fjalë në pikën 4 me vendimin nr. 73, datë 27.11.2007; hequr togflalësh në pikën 1 me vendimin nr. 48, datë 30.3.2016; shtuar pika 1/1 me vendimin nr. 49, datë 3.7.2019; ndryshuar nënndarja ‘iii’ e shkronjës ‘a’ të pikës 1, shtuar nënndarja ‘ii’ dhe ‘iv’ me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

1. Banka jep ose refuzon dhënien e licencës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike pas plotësimit të kërkesave të parashikuara në nenin 6, nenin 8 dhe nenin 9 pika 4 të kësaj rregulloreje.

1/1. Banka, përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, refuzon dhënien e licencës edhe:

- a) në rast se vërtetohet se:
 - i) struktura e shoqërisë që kërkohet të licencohet apo burimi i saj i kapitalit lidhet me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë;
 - i/i. aksioneri/ortaku, pronari përfitues dhe administratori i subjektit nuk gëzojnë reputacion të mirë;
 - ii) aksioneri/ortaku, pronari përfitues i subjektit zotëron aksione të mbajtësit (bearer shares), ose është aksioner përfaqësues (nominee shareholder) (nëse është e aplikueshme);
 - iii) aksioneri/ortaku, pronari përfitues i subjektit paraqet rrezik të lartë, bazuar në vlerësimet e Bankës së Shqipërisë;
 - iv. aksioneri/ortaku, pronari përfitues i subjektit ka qenë pjesë e strukturës së pronësisë së një zyre këmbimi valutor apo institucioni tjetër financiar, ndaj të cilit është

vendosur masa e revokimit të licencës nga Banka e Shqipërisë;

b) në çdo rast që licencimi i subjektit do të cenonte interesat e publikut.

2. Banka, brenda 3 (tre) ditëve pune nga data e marrjes së vendimit sipas pikës 1 të këtij neni, i dorëzon subjektit licencën ose e njofton atë me shkrim mbi refuzimin e dhënies së saj, duke shpjeguar arsyet përkatëse.

3. Licenca është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patjetërsueshme.

4. Subjekti mund të ushtrojë veprimtarinë e tij në një ose më shumë zyra, për të cilat Banka lëshon një licencë të vetme.

5. Licenca përfshin emrin tregtar të subjektit, numrin dhe datën e lëshimit të saj.

6. Licenca shoqërohet me kartën e identitetit për çdo kambist të subjektit, që autorizon kryerjen e veprimtarisë së këmbimit valutor, në emër dhe për llogari të këtij subjekti.

Neni 11

Miratimi i veprimtarisë shtesë në rolin e agjentit

(Shtuar fjalë në fjalinë e dytë me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011; shfuqizuar me vendimin nr. 48, datë 30.3.2016)

Neni 12

Komisionet

(Numërtuar pika 1, ndryshuar togfjalësha në shkronjat ‘a’, ‘b’ të pikës 1, shtuar pika 2 me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

1. Subjekti për të ushtruar veprimtarinë e këmbimit valutor, paguan në Bankë komisionet si më poshtë:

a) për dhënien e licencës shumë prej 3,000 (tre mijë) lekësh; dhe

b) për çdo kartë identifikimi të kambistëve shumë prej 1,000 (një mijë) lekësh.

2. Të dhënat për llogarinë ku paguhen komisionet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, janë si më poshtë:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë

BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L.

KREU III

ORGANIZIMI DHE VEPRIMTARIA E ZYRAVE TË KËMBIMIT VALUTOR

Neni 13

Organizimi

Subjekti krijohet dhe funksionon si shoqëri tregtare në bazë të ligjit “Për shoqëritë tregtare”.

Neni 14

Veprimtaria e këmbimit valutor

(Shtuar togfjalësh në pikën 4 me vendimin nr. 73, datë 27.11.2007; shtuar togfjalësh kudo në nen me vendimin nr. 31, datë 30.4.2014; ndryshuar emërtimi i nenit dhe dhe shfuqizuar pika 3 dhe 4 me vendimin nr. 48, datë 30.3.2016; shfuqizuar pika 2 me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

1. Veprimtaria e këmbimit valutor në zyrë ushtrohet vetëm nga kambistët e autorizuar, të cilët identifikohen nga karta përkatëse e lëshuar nga Banka.

- 2 Shfuqizuar.
3. Shfuqizuar.
4. Shfuqizuar.

Neni 15

Kërkesat gjatë ushtrimit të veprimtarisë

(Shtuar pikat 3 dhe 4 me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

1. Subjekti i licencuar për ushtrimin e veprimtarive të përcaktuara në nenin 14 të kësaj rregulloreje:

- a) organizon dhe mban kontabilitetin, në formën e përcaktuar nga ligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- b) mban libra arke për çdo monedhë;
- c) mban bilancin valutor; si dhe
- d) llogarit pozicionin e hapur nga këmbimet valutore, në fund të çdo dite.

2. Informacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ruhet sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga ligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

3. Subjekti i licencuar, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së këmbimit valutor:

a) nuk mban në arkë vlera monetare (cash) mbi baza ditore, më të larta se kufijtë e përcaktuar në nenin 59/2, pika 5 të ligjit “Për procedurat tatimore”, në lidhje me limitin e arkës, ose sipas ndryshimeve të mundshme pasuese të këtij legjislacioni;

b) nuk kryen transaksione në para fizike (cash), të cilat tejkalojnë një shumë prej 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, të kryera në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura me njëri-tjetrin. Transaksionet që tejkalojnë shumën 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, kryhen nëpërmjet llogarive bankare ose llogarive të pagesave të subjektit dhe klientit.

4. Subjekti, në përputhje me natyrën, madhësinë, kompleksitetin e veprimtarisë dhe profilin e rrezikut të tij, mund të krijojë njësinë e kontrollit të brendshëm. Krijimi i njësisë së kontrollit të brendshëm bëhet me vendim të organeve drejtuese të subjektit, ku përcaktohen në mënyrë të qartë, përbërja, kompetencat dhe rregullat e funksionimit të kësaj njësie.

Neni 16

Transparenca

(Shtuar togfjalësh në shkronjën “b” dhe shtuar shkronja “e” me vendimin nr. 31, datë 30.4.2014; shfuqizuar shkronja “c” dhe ndryshuar shkronja “d” me vendimin nr. 48, datë 30.3.2016; zëvendësuar togfjalësh në paragrafin e parë me vendimin nr. 49, datë 3.7.2019)

Subjekti, gjatë ushtrimit të veprimtarive të përcaktuara në nenin 14, siguron transparencën ndaj klientit:

a) duke afishuar në një vend të dukshëm në zyrën/zyrat e tij licencën e marrë nga Banka;

b) duke afishuar në një vend të dukshëm në zyrën/zyrat e tij, kurset e këmbimit dhe komisionet (nëse aplikohen) që përdor për veprimtarinë e këmbimit valutor;

c) shfuqizuar;

d) pajisur klientin me faturë për çdo transaksion këmbimi valutor, si dhe duke ruajtur një kopje të saj.

e) informuar klientin përpara kryerjes së transaksionit, në rast të aplikimit të komisioneve, nëpërmjet “Deklaratës për njohjen paraprake me komisionin e aplikuar”, të përcaktuar në aneksin nr. 8 bashkëlidhur kësaj rregulloreje. Subjekti e ruan deklaratën, jo më pak

se një muaj pas nënshkrimit të saj nga klienti.

Neni 17

Parandalimi i pastrimit të parave dhe i financimit të terrorizmit

(Hequr fjalë në paragrafin e parë, shtuar fjalë në shkronjën 'a' me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011)

Subjekti gjatë ushtrimit të veprimtarive të përcaktuara në këtë rregullore, vepron në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, veçanërisht në lidhje me:

a) identifikimin e klientit sipas dokumentacionit të kërkuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

b) ruajtjen e të dhënave mbi klientin dhe mbi transaksionet e kryera, sipas afateve të kërkuara;

c) raportimin pranë autoriteteve përkatëse, për transaksionet e dyshimta dhe për transaksionet, vlera e të cilave tejkalon kufirin e përcaktuar nga ligji "Për parandalimin e pastrimit të parave".

KREU V MBIKËQYRJA

Neni 18

Ushtrimi i mbikëqyrjes

1. Banka, realizon procesin e mbikëqyrjes së veprimtarisë së subjekteve të licencuara, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, nëpërmjet:

a) inspektimeve në vend;

b) mbledhjes së të dhënave financiare për veprimtaritë që ushtrojnë subjektet;

c) zbatimit të masave ndëshkimore, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

2. Inspektimet në vend sipas pikës 1, shkronja "a" të këtij neni realizohen për të vlerësuar përputhshmërinë e veprimtarisë së ushtruar nga subjekti me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe me dispozitat e kësaj rregulloreje në fazën e licencimit, të ushtrimit të veprimtarisë deri në revokimin e licencës së saj.

Në fund të çdo inspektimi, hartohet raporti i inspektimit nga Departamenti i Mbikëqyrjes, i cili i dërgohet subjektit, së bashku me rekomandimet dhe/ose masat ndëshkimore të propozuara.

3. Mbledhja e të dhënave financiare për veprimtarinë që ushtron subjekti, organizohet sipas nevojave të Bankës së Shqipërisë.

4. Për shkeljet e konstatuara, të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi nga subjekti, Banka zbaton masat ndëshkimore të përcaktuara në dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 19

Raportimet

(Shtuar pika 4/1 me vendimin nr. 49, datë 3.7.2019; ndryshuar pika 1, shkronja 'a' e pikës 4/1 dhe pika 5, shfuqizuar pikat 2, 3 dhe 4 me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

1. Subjekti raporton në Bankën e Shqipërisë për veprimet e këmbimit valutor, sipas kërkesave dhe afateve të parashikuara në udhëzimin nr. 3, datë 22.12.2021 "Për raportimin e veprimeve të këmbimeve valutore", miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe, në rastet kur subjekti ushtron veprimtarinë në dy ose më shumë zyra, informacioni raportohet mbi baza të konsoliduara për të gjitha zyrat, në një raportim të vetëm.

2. Shfuqizuar.
3. Shfuqizuar.
4. Shfuqizuar.

4/1. Subjektet raportojnë, brenda muajit janar të çdo viti, në Departamentin e Mbikëqyrjes, informacionin/dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vërtetim nga Ministria e Drejtësisë se aksioneri/ortaku, pronari përfitues dhe administratori nuk është i dënuar penalisht (dokumenti duhet të jetë i lëshuar jo më larg se 3 (tre) muaj nga dita e paraqitjes së tij);

b) deklaratë personale e aksionerit/ortakut, pronarit përfitues dhe administratorit për lidhje të mundshme familjare apo marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (sipas aneksit nr. 9, të kësaj rregulloreje);

c) deklaratë personale e administratorit që subjekti vazhdon të plotësojë kushtet në bazë të të cilave ai është licencuar;

Banka e Shqipërisë, përveç sa kërkohet në këtë pikë, ka të drejtën të kërkojë informacion shtesë gjatë procesit të vlerësimit të këtij dokumentacioni.

5. Raportimet nga ana e subjektit në Bankë sipas pikës 4/1 të këtij neni, bëhen në rrugë elektronike ose me postë.

Neni 20

Masat ndëshkimore

(Shtuar togfjalësh në shkronjën “d” dhe shtuar shkronjat “i” dhe “j” me vendimin nr. 31, datë 30.4.2014; ndryshuar shkronja “c” dhe “d” e pikës 2 me vendimin nr. 48, datë 30.3.2016; shfuqizuar shkronja “a” dhe shtuar shkronjat “k” dhe “l” në pikën 2 me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

1. Banka kur konstaton se subjekti është në shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje, merr masa ndëshkimore sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

2. Banka gjobit subjektin dhe/ose administratorin e saj, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë deri në 100 000 (një qind mijë) lekë, kur konstaton se:

- a) Shfuqizuar.
- b) punonjësit e subjektit nuk janë autorizuar si kambistë nga Banka;
- c) subjekti nuk afishon licencën për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor;
- d) kambistët e subjektit nuk lëshojnë faturën përkatëse për transaksionet e këmbimit valutor;
- e) subjekti nuk plotëson kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë lidhur me kushtet teknike dhe të sigurisë, në përputhje me aktet nënligjore të Bankës;
- f) subjekti nuk vepron në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit;
- g) subjekti nuk raporton në Bankë, në përputhje me kërkesat e nenit 19 të kësaj rregulloreje;
- h) subjekti pa dijeninë e Bankës ka ndryshuar të dhënat e tij, mbi bazën e të cilave ai është licencuar nga Banka, dhe nuk ka njoftuar Bankën e Shqipërisë për këto ndryshime.
- i) subjekti nuk informon klientin nëpërmjet “Deklaratës për njohjen paraprake me komisionin e aplikuar”, sipas shkronjës “e” të nenit 16 të kësaj rregulloreje;
- j) kambisti ushtron veprimtarinë e këmbimit valutor jashtë ambienteve të zyrës së këmbimit valutor.
- k) subjekti nuk respekton kufizimet e nenit 15, pika 3 të kësaj rregulloreje;
- l) subjekti nuk ka njoftuar Bankën e Shqipërisë, për ndërprerjen e veprimtarisë për një periudhë kohore nga 1 deri në 3 muaj, siç parashikohet në nenin 24, pika 2 të kësaj

rregulloreje.

3. Gjambat e përcaktuara sipas pikës 2 të këtij neni paguhen për llogari të Bankës.

Neni 21

Pezullimi dhe revokimi i licences

(Ndryshuar shkronja “c” dhe “e” e pikës 2 me vendimin nr. 48, datë 30.3.2016; shtuar togfjalësh në shkronjën “c” me vendimin nr. 49, datë 3.7.2019; ndryshuar pika 1 dhe shkronja “h” e pikës 2, shtuar togfjalësh në shkronjën “i” të pikës 2 dhe pikat 2/1, 2/2 dhe 2/3 me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

1. Banka e Shqipërisë pezullon licencën e subjektit, në rast se ndaj ortakut/aksionerit ose administratorit fillon kryerja e hetimeve ose regjistrohet procedimi penal, deri në dhënien e vendimit për mosfillimin e procedimit, vendimit për pushimin e akuzës ose çështjes ose vendimit përfundimtar të gjykatës.

2. Banka revokon licencën e subjektit në rast se ky i fundit:

a) në mënyrë të përsëritur, kryen shkeljet e parashikuara në nenin 20 pika 2 të kësaj rregulloreje;

b) është përfshirë në aktivitete të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

c) ka paraqitur dokumentacion të falsifikuar gjatë procedurës së aplikimit për licencë ose gjatë procesit të raportimit në Bankën e Shqipërisë;

d) ka humbur kushtet në bazë të të cilave ai është licencuar;

e) ushtron veprimtari financiare të tjera pa licencën e Bankës së Shqipërisë;

f) nuk paguan gjobën e vendosur nga Banka sipas pikës 2 të nenit 20, të kësaj rregulloreje;

g) nuk fillon veprimtarinë brenda 45 (dyzetepesë) ditëve kalendarike nga marrja e licencës;

h) ndërpret veprimtarinë për më tepër se 3 muaj;

i) ndërpret veprimtarinë me iniciativën e tij dhe kërkon revokimin e licencës.

2/1. Vendimi për pezullimin ose revokimin e licencës i komunikohet me shkrim subjektit, duke dhënë dhe arsyet përkatëse.

2/2. Vendimi i pezullimit ose revokimit, hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.

2/3. Subjekti ndalohet të kryejë veprimtarinë e këmbimit valutor pas hyrjes në fuqi të vendimit të Bankës së Shqipërisë për pezullimin apo revokimin e licencës.

3. Në rastin e revokimit të licencës, subjekti dorëzon në Bankë licencën dhe kartat identifikuese të kambistëve.

4. Subjekti ndaj të cilit është vendosur masa e revokimit të licencës nga Banka e Shqipërisë, nuk mund të aplikojë sërish për licencim.

Neni 22

Procedura për vendosjen e masave ndëshkimore

(Ndryshuar pika 1 dhe shfuqizuar pika 2 me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

1. Banka dëgjon subjektin në përputhje me kërkesat e nenit 92 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, para vendosjes së masave ndëshkimore dhe të pezullimit ose revokimit të licencës.

2. Shfuqizuar.

Neni 23
E drejta e ankimimit

Subjekti ka të drejtën e ankimimit ndaj çdo akti administrativ të Bankës, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në nenin 93 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 24
Detyrimi për njoftim

(Hequr togfjalësh shkronjën “b” me vendimin nr. 31, datë 30.4.2014; zëvendësuar shkronjë në pikën 2 me vendimin nr. 73, datë 27.11.2007; numërtuar pika 1 dhe shtuar pikat 2, 3 dhe 4 me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

1. Subjekti gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij njofton Bankën:
 - a) menjëherë, kur ka ndryshime të kambistëve dhe kërkon pajisjen e kambistëve të rinj me karta identifikimi, pas dorëzimit në Bankë të kartave të identifikimit të kambistëve të larguar;
 - b) brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve kalendarike, për çdo ndryshim në të dhënat identifikuese, të përcaktuara në nenin 3, shkronja “e”, si dhe dokumentacionin e subjektit të përcaktuar në nenin 6, pika 1, shkronjat “a” deri “e” të kësaj rregulloreje.
2. Subjekti njofton Bankën e Shqipërisë në rast se ndërpret veprimtarinë e këmbimit valutor për një periudhë kohore nga 1 deri në 3 muaj, duke paraqitur edhe arsyet përkatëse për këtë ndërprerje.
3. Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur për njoftimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar sipas kësaj rregulloreje nuk plotësohet nga subjekti brenda 3 (tre) muajve pas datës së paraqitjes së këtij njoftimi. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të dokumentacionit, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim subjektin. Subjekti ka të drejtë të kërkojë rifillimin e procedurës së shqyrtimit të njoftimit. E drejta për të paraqitur dokumentacionin për rifillimin e procedurës, nuk mund të ushtrohet më shumë se një here, me përjashtim të rasteve kur mosrespektimi i afatit kohor të parashikuar në këtë pikë, ka ardhur për shkaqe madhore.
4. Banka e Shqipërisë, mund të kërkojë rast pas rasti, edhe dokumente apo informacione shtesë, nëse e çmon të nevojshme, përveç sa është parashikuar në këtë nen.

KREU VI

Neni 25
Dispozitë kalimtare

(Shfuqizuar pika 2 me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011)

1. Subjektet e licencuara nga Banka përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, konsiderohen të licencuara në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje. Banka ka të drejtë t’i kërkojë subjekteve të licencuara, informacione shtesë, nëse sipas opinionit të saj, informacioni i paraqitur në kohën e marrjes së licencës nuk është në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.
2. Shfuqizuar.

Neni 26
Të fundit

1. Rregullorja “Për licencimin e zyrave të këmbimit valutor” e miratuar me vendimin nr. 65, datë 30.7.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohet.

2. Rregullorja “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor” hyn në fuqi me publikimin e saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

ANEKSI 1

A P L I K I M

PËR LICENCË PËR ZYRË KËMBIMI VALUTOR

(Shtuar pika 10 me vendimin nr. 31, datë 30.4.2014; ndryshuar togfjalësh në pikën 1, 3, 5, 9 dhe shtuar fjalë në pikën 9 me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

1. Emri i plotë _____
(i shoqërisë që aplikon për licencë)

2. Selia e shoqërisë _____

3. Personi/personat që përfaqësojnë zyrën e këmbimit valutor sipas regjistrimit në _____

Qendrën Kombëtare të Biznesit

1. _____

2. _____

etj.

5. *Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIIS)*

6. Kodi i identifikimit në regjistrin tatimor (Kodi fiskal/NIPT-i).

7. Llogari bankare të hapura në banka në Shqipëri.

(emri i bankës, monedha, numri i llogarisë)

1. _____

2. _____

etj.

8. Adresa e plotë e vendit ku kërkohet të ushtrohet veprimtaria e Zyrës së Këmbimit,

1. _____

2. _____

etj.

9. *Numri i telefonit për Zyrën e Këmbimit Valutor dhe personat e kontaktit.*

1. _____

9. Emrat e personit/ave që do të ushtrojnë veprimtarinë e këmbimit valutor (*kambist*);

1. _____

2. _____

etj.

10. Adresën/at elektronike të zyrës së këmbimit valutor

“ _____ ”

Data _____

Aplikanti _____

ANEKSI 2

(Shfuqizuar me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

ANEKSI 3

(Shfuqizuar me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

ANEKS NR.4
FORMULAR VETËDEKLARIMI

(Shtuar me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011; shfuqizuar me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

ANEKS NR.5
DEKLARATË PERSONALE MBI USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË KËMBIMIT
VALUTOR
ADMINISTRATORI

(Shtuar me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011; ndryshuar me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

“ANEKS NR. 5

**DEKLARATË PERSONALE MBI USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
KËMBIMIT VALUTOR****ADMINISTRATORI****SHOQËRIA _____ SH.P.K / SH.A**

Nëpërmjet kësaj deklarate synohet rritja e mëtejshme e përgjegjshmërisë së administratorëve në ushtrimin e funksioneve të tyre, në përputhje të plotë me detyrimet ligjore dhe/ose nënligjore, për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor.

Unë, i/e nënshkruari/a _____, identifikuar nëpërmjet (lloji i mjetit të identifikimit) _____ nr. _____ dhe me datë lëshimi _____, lindur në qytetin e _____ dhe me banim në (adresa) _____, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, si dhe në rolin e administratorit të shoqërisë “_____” sh.p.k/sh.a, me seli (adresa) _____, deklaroj nën përgjegjësinë dhe vullnetin tim të lirë se jam i ndërgjegjshëm dhe njohës i përgjegjësi, kërkesave dhe detyrimeve të kuadrit ligjor dhe/ose nënligjor që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor në Republikën e Shqipërisë, dhe në veçanti të kërkesave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi, por pa u kufizuar vetëm në:

1. Ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij dhe Ligjin nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;
2. Ligjin nr. 112, datë 29.7.2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar;
3. Ligjin Nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar;
4. Ligjin Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
5. Ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
6. Rregulloren nr. 31, datë 06.06.2007 “Për licencimin, organizmin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”, e ndryshuar;
7. Rregulloren nr. 48, datë 2.10.2024 “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare”;
8. Rregulloren nr. 44, datë 10.06.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e ndryshuar.

Me respekt,

Z/Znj. _____

Administrator/e i/e Shoqërisë “____” Sh.p.k/Sh.a

(nënshkrim/firmë, vulë)

Shënim: Aktet e parashikuara në pikën 1 mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë së Inteligjencës Financiare (<https://fii.gov.al/>)

Aktet e parashikuara në pikat 5 deri në 8, mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë (www.bankofalbania.org.”

ANEKS NR.6

INFORMACION MBI PAJISJET TEKNIKO-ADMINISTRATIVE

(Shtuar me vendimin nr. 82, datë 14.12.2011; ndryshuar me vendimin nr. 31, datë 30.4.2014; ndryshuar togfjalësh dhe shtuar paragraf me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

Zyra e këmbimit valutor, e vendosur në adresën....., ka krijuar kushtet tekniko-administrative për realizimin e aktivitetit të këmbimit valutor.

Pajisjet tekniko-administrative, që disponon zyra për ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lloji i pajisjes	Disponueshmëria e pajisjes
• Kompjuter, printer dhe/ose aksesoret e tyre	√
• Fotokopje dhe/ose skaner	√
• Mjete komunikimi (telefon, e-mail)	√
• Makinë të numërimit dhe të verifikimit të parave	√
• Tabelë e shfaqjes për publikun të kursit të këmbimit dhe të komisioneve (nëse aplikohen)	√
• Faturë tip për veprimet në sportel	√
• Tabelë e jashtme e shoqëruar me emërtimin ligjor të zyrës	√

Informacioni i kërkuar sipas nenit 6, pika 1, shkronja “i” të kësaj rregulloreje, mund të shtohet edhe për pajisjet shtesë që zyra disponon, të cilat e ndihmojnë (zyrën) në ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor .

Datë _____

Me respekt,

Z/znj. _____

Administrator/e i/e shoqërisë “ _____ ” sh.p.k./sh.a.

(nënshkrim/firmë, vulë)

ANEKSI NR. 7

INFORMACION MBI MJEDISËT DHE KUSHTET E SIGURISË

(Shtuar me vendimin nr. 31, datë 30.4.2014; shtuar fjalë me vendimin nr. 48, datë 30.3.2016;
hequr togfjalësh dhe shtuar paragraf me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

Zyra e këmbimit valutor, e vendosur në adresën....., ka krijuar kushtet e sigurisë për realizimin e aktivitetit të këmbimit valutor, siç paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Kushtet	Disponueshmëria
• Zyra ka hapësira të nevojshme dhe kushte të përshtatshme për mirëmbajtjen e dokumentacionit dhe vlerave monetare	√
• Zyra ka qartësisht të ndarë zonën e pritjes së klientit nga zona e arkëtarëve	√
• Zona e arkëtarëve kufizohet nga zonat e tjera me sportel	√
• Vlerat monetare mbahen në kasafortë	√
• Zyra monitorohet me telekamera	√
• Telekamerat filmojnë në mënyrë të pandërprerë	√
• Zyra ka pajisje digjitale për regjistrimin e pamjeve	√

Informacioni i kërkuar sipas nenit 6, pika 1, shkronja “j” të kësaj rregulloreje, mund të shtohet edhe për pajisjet shtesë që zyra disponon, të cilat e ndihmojnë (zyrën) në ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor .

Subjekti ka detyrimin të njoftojë strukturat përkatëse të Policisë Vendore për adresën ku do të hapen zyrat, si dhe të pajiset për ambientet në të cilat do të ushtrojë veprimtarinë e tij, me dokumentin “Vërtetim sigurie”, lëshuar nga drejtoritë vendore të Policisë, siç parashikohet në nenin 13, pikat 5 dhe 6 të rregullores 48/2024 “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare”. Këto dokumente duhet të jenë të disponueshme kur Banka kryen inspektimin sipas parashikimit të pikës 4, të nenit 9 të kësaj rregulloreje.

Datë _____

DEKLARATË
(Shtuar me vendimin nr. 49, datë 3.7.2019; ndryshuar togfjalësha dhe shtuar paragraf me
vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

Nëpërmjet së cilës, unë vërtetoj se kam/nuk kam lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë.

Shënim: Në rastin kur *aksioneri/ortaku/pronari përfitues/administratori* deklaron se ka lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë, rendit në vijim emrat e personave.

Nr.	Emri i personit të lidhur me <i>aksionerin/ortakun/pronarin përfitues/administratorin</i>	Lloji i lidhjes (familjare apo marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore), duke e specifikuar	Ka dënim penal të formës së prerë (sqaro llojin e dënimit)
1			
2			
3			
...			

Vërtetoj se informacioni i dhënë, i paraqitet vullnetarisht nga unë, Bankës së Shqipërisë.

Në qoftë se kërkohet informacion shtesë ose më i detajuar, unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

(Emri/Mbiemri i aksionerit/ortakut/pronarit përfitues/administratorit

_____/_____/_____
(data)

(nënshkrimi i plotë)”

Shënim. Për qëllime të plotësimit të këtij formulari, lidhje familjare me një person do të konsiderohen të afërmit e ngushtë sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 10, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, ku përfshihen: a) fëmijët (ose të birësuarit); b) fëmijët e fëmijëve; c) bashkëshorti/ja; d) prindërit; e) vëllezërit, motrat, si dhe fëmijët e tyre; f) personat në kujdestarinë e tij.

ANEKSI nr. 10
(Shtuar Aneksi nr. 10 me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025)

“ANEKS NR. 10

Nr. _____ Prot. _____ Data _____._____._____

Lënda: Lista e përdoruesve të sistemit ERRS

BANKËS SË SHQIPËRISË

Departamentit të Operacioneve Monetare

Departamentit të Statistikave Financiare

Sheshi “Skënderbej”, nr. 1, Tiranë.

Në kuadër të automatizimit të raportimit të veprimeve valutore pranë Bankës së Shqipërisë nëpërmjet Sistemit Elektronik Raportues Rregullator (ERRS), zyra e këmbimit valutor _____, me nr. Licence _____, me adresë _____,

kërkon hapjen e llogarisë së përdoruesit në këtë sistem.

Personat e autorizuar nga zyra jonë si përdorues të sistemit ERRS janë si më poshtë:

1. _____ në rolin e ngarkuesit.
(Emër mbiemër) (adresë e-mail)

_____ në rolin e dërguesit.
2. (Emër mbiemër) (adresë e-mail)

Duke ju falënderuar paraprakisht për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.

Me respekt

(Emër mbiemër firmë)

Vula e shoqërisë”